

**AKT THEMELIMI**  
**dhe**  
**STATUTI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“FB CONSULTING” Sh.p.k.**

**KAPITULLI I**  
**EMRI, FORMA E SHOQËRISË, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA**

**Neni 1**  
**Themelimi**

- 1.1 Emri i shoqërisë është **“FB CONSULTING”** Sh.p.k (këtu më poshtë e quajtur **“Shoqëria”**). Shoqëria është themeluar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 1.2 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 1.3 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin.

**Neni 2**  
**Selia**

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: "Rruga “Dervish Hima”, Ndërtesa Ambasador 3, Kati i 20, Zyra nr. 159, Tiranë, Shqipëri".
- 2.2 Shoqëria mund të themelojë degë, filiale dhe/ose zyra përfaqësimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe/ose në shtete të tjerë, në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe Statutin.

**Neni 3**  
**Objekti**

- 3.1 Objekti kryesor i Shoqërisë do të jetë:
  - Shërbime menaxhimi projektesh;



- Shërbime konsulence, juridike, financiare dhe çdo lloj tjetër shërbimi konsulence;
- Kryerja e punimeve ndërtimore për ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore, punime restaurimi, ndërtim rruge, kanalizime, si dhe çfarëdolloj ndërtimi tjetër në përputhje me licencën përkatëse, etj;
- Blerja, shitja, shkëmbimi apo kalimi në çfarëdolloj mënyre tjetër të lejuar nga ligji i pasurive të paluajtshme, apo të drejtave reale të lidhura me to, qofshin këto ekzistuese apo të ardhshme, të krijuara rishtazi apo të fituara nga të tjerë;
- Dhënia me qira, huapërdorje, uzufrukt apo kalimi në çfarëdolloj mënyre tjetër të lejuar nga ligji i të drejtës posedimore të pasurive të paluajtshme, apo të drejtave reale të lidhura me to qofshin këto kalime me apo pa afat, me apo pa shpërblim;
- Import/eksport, blerje, shitje, shkëmbim, dhënia me qira apo huapërdorje të veshjeve të ndryshme;
- Furnizimi i shërbimeve të kohës së lirë dhe kënaqësisë duke përfshirë shërbime bar-kafene, restoranti, kalçeto etj.;
- Pjesëmarrja në investime industriale dhe tregtare si dhe në veprimtari të ndryshme financiare tregtare, industriale dhe aktivitete qeveritare;
- Themelimi i shoqërive në formën e joint venture ose ortakëri me palë të treta;
- Shitja dhe blerja e kuotave/aksioneve të shoqërive të tjera;
- Shitja, blerja, transferimi ose dhënia me qira e pasurive të paluajtshme;
- Marrja ose dhënia e huave;
- Vendosja e hipotekave, pengjeve, barrëve siguruese ose mjeteve të tjera të garancisë;
- Regjistrimi i markave tregtare, transferimi i çdo licence, patente dhe know-how;
- Dhënia e shërbimeve të këshillimit në fushën inxhinierike;
- Çdo veprimtari tjetër e ligjshme.


3.2 Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë.

3.3 Kryerja e aktiviteteve, për të cilat nevojiten lejet dhe/ose miratimet përkatëse, do të bëhet pas marrjes së këtyre lejeve dhe/ose miratimeve.

#### **Neni 4**

#### **Kohëzgjatja**

4.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.



**KAPITULLI II**  
**KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, KUOTAT**

**Neni 5**

**Kapitali Themeltar dhe Ortaku i Vetëm**


- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 10.000 (dhjetëmijë) lekë, i ndarë në 1 (një) kuotë.
- 5.2 Ortaku i Vetëm i Shoqërisë zotërues i 1 (një) kuote, të barabartë me 10.000 (dhjetëmijë) lekë që përfaqëson 100% të kapitalit është:
- Znj. Fiorilda Bregu**, shtetase Shqiptare, lindur në Korçë, Shqipëri më 09.08.1982, banuese në "Rruga "Dervish Hima", Ndërtesa Ambasador 2, Kati i 2, Ap. nr. 7, Tiranë, Shqipëri", mbajtëse e letërnjoftimit me nr. personal I25809159L, zotëruese e një kuote me vlerë 10.000 (dhjetëmijë) lekë, që përfaqëson 100% të kapitalit;
- 5.3 Kapitali themeltar do të shlyhet plotësisht në para nga Ortaku i Vetëm me themelimin e Shoqërisë.
- 5.4 Përgjegjësia e Ortakut të Vetëm shtrihet deri në shumën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

**KAPITULLI III**  
**ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË**

**Neni 6**

**Ortaku i Vetëm**

- 6.1 Ortaku i Vetëm është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë.
- 6.2 Ortaku i Vetëm ka funksionet e mëposhtme:
- Përcakton politikat tregtare dhe ekonomike të Shoqërisë dhe mbikëqyr zbatimin e këtyre të fundit nga administratori/ët;
  - Emëron dhe shkarkon administratorin/ët;
  - Emëron dhe shkarkon ekspertin (et) kontabël dhe/ose likuiduesin (t) e Shoqërisë;
  - Përcakton shpërblimin e administratorit/ëve, ekspertit/ëve kontabël dhe likuiduesit/ve;



- Miraton pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë të përgatitura nga administratori/ët;
- Merr vendim për ndryshimet e këtij Statuti dhe të Aktit të Themelimit;
- Merr vendim për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
- Merr vendim për shpërndarjen e fitimeve, dividendëve;
- Merr vendim për ristrukturimin e Shoqërisë ose prishjen e saj;
- Merr vendim për çdo çështje tjetër të parashikuar nga ligji.

## **Neni 7**


### **Regjistri i Vendimeve**

- 7.1 Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm do të regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen. Regjistri i Vendimeve do të mbahet nga Shoqëria, dhe çdo regjistrim do të nënshkruhet nga administratori/ët.

## **Neni 8**

### **Administratori**

- 8.1 Shoqëria administrohet nga 1 (një) administrator, i emëruar me vendim të Ortakut të Vetëm.
- 8.2 Administratori i Shoqërisë është:
- **Znj. Fiorilda Bregu**, shtetase Shqiptare, lindur në Korçë, Shqipëri më 09.08.1982, banuese në "Rruga "Dervish Hima", Ndërtesa Ambasador 2, Kati i 2, Ap. nr. 7, Tiranë, Shqipëri", mbajtëse e letërnjoftimit me nr. personal I25809159L.
- 8.3 Mandati i administratorit është për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh, i ripërtërishëm, dhe, nëse është rasti, vazhdon deri në vendimin e ardhshëm të Ortakut të Vetëm që do të marrë vendim në lidhje me rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit të ri.
- 8.4 Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori.
- 8.5 Kompetencat e Administratorit:  
Përveçse kur parashikohet ndryshe me vendimin përkatës të Ortakut të Vetëm për emërimin e administratorit, administratori ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:



- Administrimin e veprimtarisë së Shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare dhe ekonomike të përcaktuara nga Asambleja e Ortakëve;
- Përfaqësimin e Shoqërisë në marrëdhënie me çdo palë të tretë;
- Marrjen e masave për hartimin dhe mbajtjen në mënyrën e duhur të pasqyrave financiare dhe të dokumenteve;
- Përgatitjen dhe nënshkrimin e pasqyrave financiare vjetore dhe bilanceve të konsoliduara, përgatitjen e raportit të ecurisë dhe dorëzimin e këtyre të fundit bashkë me propozimin përkatës për shpërndarjen e fitimeve Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- Krijimi e sistemit të paralajmërimit në lidhje me rrethanat, të cilat kërcënojnë veprimtarinë e Shoqërisë;
- Dorëzimin në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dokumenteve dhe të dhënave të Shoqërisë, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe;
- Raportimin tek Asambleja e Ortakëve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare të Shoqërisë dhe në lidhje me përmbushjen e transaksioneve të një rëndësie të veçantë për ecurinë e Shoqërisë;
- Kryerjen e çdo detyre tjetër të parashikuar nga ligji ose nga ky Statut.

8.6 Administratori mund të autorizojë palë të tretë të përfaqësojë Shoqërinë dhe të nënshkruajë çdo dokument, kërkesë ose aplikim në emër dhe për llogari të Shoqërisë;

8.7 Administratori është përgjegjës ndaj Shoqërisë për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e mospërmbushjes së detyrimeve të parashikuara nga dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacioni në fuqi.

#### **KAPITULLI IV**


#### **VITI FINANCIAR – SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

##### **Neni 9**

##### **Viti Financiar**

9.1 Viti financiar fillon në 1 Janar dhe përfundon në 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.

9.2 Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 Dhjetor 2021.



**Neni 10**  
**Shpërndarja e Fitimeve**

- 10.1 Pas miratimit të pasqyrave vjetore financiare dhe në rast se janë realizuar fitime, Ortaku i Vetëm vendos në lidhje me shpërndarjen ose jo të këtyre të fundit.

**KAPITULLI V**  
**DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

**Neni 11**  
**Ligji i Zbatueshëm**


- 11.1 Për të gjitha çështjet që nuk parashikohen në këtë Statut do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në lidhje me shoqëritë tregtare.

**Neni 12**  
**Të ndryshme**

- 12.1 Ky Statut është nënshkruar në 3 (tre) kopje origjinale në shqip.

**ORTAKU I VETËM**  
**Për "FB CONSULTING" Sh.p.k**

**Znj. Fiorilda Bregu**

Fiorilda Bregu  


Tiranë më 23 .02.2021